



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2014 - 2016



Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Qershor, 2017

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), ka përgatitur publikimin e Llogarive Qeveritare të Kosovës për vitin 2016. Ky publikim është përgatitur në përputhje me Udhezuesin e Fondit Monetar Nderkombëtar për Statistikat e Financave Qeveritare (GFSM 2014) dhe Sistemin e Llogarive Evropiane (ESA 2010)*. Publikimi paraqet pasqyrën e të hyrave dhe shpenzimeve qeveritare brenda kësaj periudhe.

ASK-ja i është mirënjohës Ministrisë së Financave – Departamenti i Thesarit, Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) për ofrimin e të dhënave në lidhje me këtë publikim.

**Shënim: Përgatitja e këtij publikimi sipas standardeve të cekura, është perkrahur nga asistencat teknike të Fondit Monetar Nderkombëtar (FMN), financuar nga Konfederata e Zvicres për periudhën (2016-2018). ASK do të vazhdojë të bëjë ndryshimet në përputhje me GFSM 2014 dhe ESA 2010 edhe për vitet paraprake (2008-2014).*

Komentet, propozimet dhe sugjerimet tuaja janë të mirëseardhura dhe ato mund të drejtohen në adresën elektronike: infoask@rks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha – Drejtor i departamentit,
Xhevdet Fetahu – Shefe e divizionit,
Ilir Mazrekaj – zyrtar i lartë,
Ylli Shala – zyrtar i lartë.

Prishtinë, Qershor 2017

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
z. Isa Krasniqi

Lista e Shkurtesave

ASK	-	Agjencia e statistikave të Kosovës
MF	-	Ministria e Financave
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ESA2010	-	Sistemi i Llogarive Evropiane (European System of Accounts)
GFSM2014	-	Udhezuesi për Statistikat e Financave Qeveritare
COFOG	-	Klasifikimi i shpenzimeve të qeverisë sipas funksionit
TKPK	-	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
:	-	Mungojnë të dhënat
—	-	Nuk aplikohet

Përmbajtja

	Faqe
1. Hyrje.....	4
2. Të hyrat - Qeveria e përgjithshme.....	5
Tabela 1: Të hyrat e Qeverisë së përgjithshme bazuar ne ESA2010 (2015- 2016).....	5
Grafiku 1. Të hyrat - Qeveria e përgjithshme bazuar ne ESA2010.....	6
3. Shpenzimet – Qeveria e përgjithshme	7
Tabela 2. Shpenzimet e Qeverisë së përgjithshme bazuar në ESA2010 (2015 – 2016).....	7
Grafiku 2. Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme bazuar në ESA2010.....	8
Tabela 3. Shpenzimet Qeveritare në baze të klasifikimit COFOG (2015 – 2016)	9
Grafiku 3. Struktura e shpenzimeve për 2016 ne baze te klasifikimit COFOG.....	10
Tabela 4: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës (2004-2016).....	11

1. Hyrje

Publikimi paraqet një pasqyrë të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 2015 – 2016, bazuar në mbledhjen e të dhënave administrative dhe kalkulimeve të ASK-së.

Publikimi është përgatitur sipas Udhezuesit të Fondit Monetar Nderkombëtar për Statistikat e Financave Qeveritare (GFSM 2014) dhe sipas Sistemit të Llogarive Evropiane (ESA 2010)

.

Burimet e të dhënave janë: Ministria e Financave – Departamenti i Thesarit dhe Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës .

2. Të hyrat - Qeveria e përgjithshme

Shuma e të hyrave të Qeverisë së përgjithshme për vitin 2016 ishte 1,779.3 milion Euro. Në krahasim me vitin paraprak kemi një rritje prej 4.3% të të hyrave.


Pjesën më të madhe të të hyrave e përbëjnë tatimet në produkte të cilat paraqesin 69% të totalit të të hyrave, tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj 13%, ndërsa pjesa e mbetur e të hyrave është shpërndarë në kategori tjera të të hyrave.

Tabela 1: Të hyrat e Qeverisë së përgjithshme bazuar ne ESA2010 (2015- 2016)

<i>(në milion Euro)</i>			
ESA2010	Përshkrimi	2015	2016
D21	Tatimet në produkte	1.093.9	1.220.1
D211	Tatimi mbi vleren e shtuar(TVSH)	584.3	664.4
D212	Tatimi dhe dogana ne importe duke perjashtuar TVSH	486.5	527.4
D2121	<i>Detyrimet e importit</i>	130.7	129.9
D2122	<i>Taksat për importet pa TVSH dhe detyrimet</i>	355.8	397.5
D214	Tatimi mbi produktet, me përjashtim të TVSH-së dhe tatimet e importit	23.1	28.3
D29	Tatimet tjera në prodhim	57.9	46.4
D4	Të hyrat nga prona	16.5	7.2
D5	Tatimet rrjedhëse në të ardhura, pasuri, etj.	205.1	236.0
D7	Transfertat e tjera aktuale	27.8	23.1
F	Aktivitet dhe detyrimet financiare	227.8	154.8
P131	Pagesat për output jo-tregut (Shitjet)	77.0	91.7
Gjithsej		1.706.1	1.779.3

Struktura e të hyrave të Qeverisë së përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 1:

Grafiku 1. Të hyrat - Qeveria e përgjithshme bazuar ne ESA2010



3. Shpenzimet – Qeveria e përgjithshme

Në vitin 2016 shuma e shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme ishte 1,764.7 milion Euro.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve e përbëjnë: kompensimi i punëtorëve 31%, kontributet sociale dhe përfitimet 23%, formimi i kapitalit bruto 22%, konsumi i ndërmjetëm 10%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në kategorite tjera të shpenzimeve.


Tabela 2. Shpenzimet e Qeverisë së përgjithshme bazuar në ESA2010 (2015 – 2016)

(në milion Euro)

ESA2010	Përshkrimi	2015	2016
D1	Kompensimi i punëtorëve	526.3	544.8
D3	Subvencionet	86.8	82.1
D4	Të hyrat nga prona	15.9	19.1
D6	Kontributet sociale dhe përfitimet	345.0	408.4
D7	Transfertat e tjera aktuale	14.5	13.3
D9	Transfertat kapitale	30.6	39.1
F	Aktivet dhe detyrimet financiare	29.6	67.3
NP	Posedimi i aktiveve jo-prodhuese	31.3	29.1
P2	Konsumi i ndërmjetëm	181.5	177.5
P5	Formimi i kapitalit bruto	350.7	383.7
Gjithsej		1.612.3	1.764.7

Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme është e prezantuar në Grafikon 2:

Grafiku 2. Struktura e shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme bazuar në ESA2010



Në vitin 2016 shuma e shpenzimeve të Qeverisë së përgjithshme ishte 1,764.7 milion Euro. Shpërndarja e shpenzimeve sipas këtij klasifikimi është siç vijon: çështjet ekonomike 22%, arsimi 22%, mbrojtja sociale 16%, shërbimet e përgjithshme 10%, ndërsa pjesa e mbetur e shpenzimeve është shpërndarë në sektorët e tjerë.


Tabela 3. Shpenzimet Qeveritare në baze të klasifikimit COFOG (2015 – 2016)

(në milion Euro)

Përshkrimi	2015	2016
Shërbimet e përgjithshme	369.3	179.5
Mbrojtja	34.8	104.6
Rendi dhe siguria publike	84.6	160.3
Çështjet Ekonomike	322.8	385.6
Mbrojtja e Mjedisit	13.9	19.8
Strehim dhe pajisje për Komunitetin	28.6	42.1
Shëndetësia	164.8	168.2
Rekreacioni, kultura dhe Religjioni	33.3	38.3
Arsimi	261.9	280.2
Mbrojtja sociale	298.3	386.0
Gjithsej	1.612.3	1.764.7

Shpërndarja e shpenzimeve sipas sektorëve (në përqindje) është paraqitur në grafikun 3.

Grafiku 3. Struktura e shpenzimeve për 2016 ne baze te klasifikimit COFOG



Sistemi i fondit pensional

Sistemi pensional është i përbërë nga 3 shtylla. Secila prej tyre dallon në mënyrën se si financohen dhe në shtresën e popullatës të cilën e mbulojnë:

Shtylla e parë - është skema e asistencës themelore sociale, e cila është e zbatueshme jo vetëm për të moshuarit. Kjo është e integruar në Qeverinë Qendrore, që do të thotë se është pjesë përbërëse e Qeverisë. Pagesat pensionale nën këtë konsiderohen si dobi sociale të përfshira në shpenzimet të "Transferet rrjedhëse të Ekonomive Shtëpiake". Kjo është e financuar nga buxheti i Qeverisë së Përgjithshme.

Shtylla e dytë - është skema e kursimeve të detyrueshme pensionale. Kjo skemë ka filluar së funksionari në gusht të vitit 2002, kur punëdhënësit e mëdhenj dhe agjencitë shtetërore kane qene te obliguara për pagesen e kontributeve. Prej vitit 2003 skema e kursimeve të obligueshme është zgjeruar për të përfshirë të gjithë punonjësit e Kosovës e të vetëpunësuarit. Kursimet e detyrueshme pensionale administrohen dhe menaxhohen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK). TKPK pranon kontribute pensionale në vlerë prej 10% të pagës bruto të ndarë në mes të punëdhënësve dhe punëtorëve (5%+5%), ndërsa për të vetëpunësuarit 10 % të të ardhurave të fituara. TKPK i investon këto mjete përmes menaxhuesve të specializuar të mjeteve.

Shtylla e tretë - Nenet e Rregullores së pensioneve mbi skemat vullnetare sigurojnë që këto skema të jenë të sigurta, të financuara në mënyrë adekuate dhe transparente. Skemat e pensioneve vullnetare paraqesin opion për biznese dhe institucione të ndryshme financiare dhe mund të financohen nga kontributet e punëdhënësve dhe/ose të të punësuarve. Departamenti i Pensioneve në [BQK](#) liçencon dhe monitoron skemat vullnetare.

Sistemi kryesor pensional është regjistruar jashtë Qeverisë. Kontributet e pagesave të pensioneve janë rrjedha në mes të Ekonomive shtëpiake dhe sektorit të korporatave financiare.

Nga këndvështrimi ekonomik nuk duket të jetë plotësisht e kënaqshme që sistemi kryesor pensional i detyrueshëm nuk është reflektuar në llogarinë e Qeverisë. Kështu që publikimet e ASK-së për Llogaritë Qeveritare, në parim përmbajnë një pasqyrë, të situatës së shtyllës së financuar (kontributet, të hyrat e aseteve, pagesat dhe asetet)

Tabela 4: Treguesit kryesor për shtyllën e 2-të pensionale të Kosovës (2004-2016)

(në milion Euro)

Vitet	Kontributet e mbledhura pensionale	Kthimet e investimeve	Provizionet, kthimet dhe pagesat tjera	Saldo e aseteve pensionale
2004	44	1	1	83
2005	52	11	2	144
2006	57	16	28	188
2007	64	6	5	252
2008	73	-91	6	228
2009	83	47	7	350
2010	95	26	8	463
2011	108	3	12	563
2012	113	54	16	715
2013	119	71	17	888
2014	129	67	21	1.063
2015	138	30	24	1.206
2016	152	65	29	1.393

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

336.12(496.51)“2014/2016”(048)

Llogaritë Qeveritare të Kosovës 2014 – 2016 / publikimin përgatitën
Ilir T. Berisha... [et al.]– Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
2017. – 12 f. : ilustr. ; 30 cm. – (Seria 3 : Statistikat Ekonomike)

1. Berisha, Ilir T.

ISBN 978-9951-22-361-4

Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë *strukture organizative: Departamentet prodhuese; (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj*

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 143 punëtorë, prej tyre, 98 (68,5%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 45 (31,5%), Agjencioni ka ketë strukture kualifikuese, 61,7% me shkollim universitar, 15,4 me shkollim të lartë, ndërsa 17,5% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshafi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** infoask@rks-qov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>

ISBN 978-9951-22-361-4

